

EMIN KABASHI

MARTIN CAMAJ DHE FILLET E POEZISË SHQIPE NË KOSOVË

Hyrje

Koha e shkrimit të poezive të Martin Camajt të përfshira në dy vëllimet e tij të para me poezi, në *Një fyell ndër male* dhe në *Kanga e vërrinit*, nuk dihet. Nuk dihet as kur ka filluar të shkruajë dhe ku, siç nuk dihet edhe a i ka bartur nga një vend në tjetrin krijimet e tij, ngase siç dihet tashti më, poeti ka bredhur mjaft shpesh duke ndërruar vende dhe toka të ndryshme.

Koha dhe vendi i botimit të vëllimeve të tij me poezi dihet. *Një fyell ndër male* është botuar më 1953 në Prishtinë, kurse një vit më vonë, më 1954, po në Prishtinë botohet vëllimi i tij i dytë me poezi *Kanga e vërrinit*.

Mirëpo, edhe një çështje tjetër interesante për mendësinë e këtyre viteve nuk dihet. Pra, nuk dihet lexuesi i poezisë së Martin Camajt të botuar në Prishtinë në ato vite.

Çështje të diskutueshme

Studiues të ndryshëm kanë thënë se poeti i këtyre dy vëllimeve në një kohë të caktuar kishte hequr dorë nga këto dy vepra të tij si shumë *konvencionale*. Lexuesit të poezisë shqipe të këtyre viteve, si kudo lexuesit në botë dhe në të gjitha kohët, nuk i intereson se çka thotë krijuesi, as për mirë e as për keq për vepra të caktuara të akëcilit krijues.

Kjo mendësi lexuesish del edhe më e qartë kur është fjala për poezinë e Martin Camajt, jo vetëm të kësaj periudhe, e cila nuk njihej gjerësisht as në Shqipërinë politike e as në Kosovë, për shkak të ideologjisë komuniste në pushtet, prandaj aq më pak lexues e dinë faktin se poeti ka hequr dorë nga krijimet e tij *konvencionale*.

Nëse kthehemi në fillim të viteve '50-'60 për të hetuar si ka qenë relievi i hartës së poezisë shqipe që krijohet në Kosovë, atëherë del jo i arsyeshëm vendimi i poetit për të hequr dorë nga krijimet e tij.

Niveli i poezisë shqipe në përgjithësi, sidomos i asaj që krijohet në Kosovë, ishte i papërfillshëm, përveç të tjerash, edhe për faktin se vëllimi me poezi *Një fyell ndër male* i Martin Camajt ishte vëllimi i parë me poezi që botohej në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore. Por, para kësaj ngjarjeje të madhe, me përmasë botërore, siç ishte Lufta e Dytë Botërore,

ç'nivel kishte poezia që krijohet në Kosovë? Ndoshta këtë e ka shpjeguar më së miri Mitrush Kuteli, në shënimet e tij kur ka vizituar Kosovën, në kohën kur kjo pjesë e tokave shqiptare ishte bashkuar me vendin e vet, Shqipërinë, pa u lëshuar në shpjegimet ideologjike se ishte bërë nga një pushtues i këtyre tokave, apo nga një tjetër. Pra, për të respektuar nivelin e informacionit kulturor të të pranishmëve, mund të thuhet se jo vetëm që nuk kishte asnjë libër të botuar në vitin 1944, por nuk kishte madje asnjë gazetë të vetme, pos ndonjë fletushke që dilte nga njësitet partizane, për të cilat nuk është folur asnjëherë, së paku si vlerë propaganduese. Prandaj, dy vëllimet me poezi të Martin Camajt, *Një fyell ndër male*, botuar më 1953 dhe *Kanga e vërrinit*, botuar më 1954, janë krijimet e para të botuara si vëllime të poezisë së re shqipe që krijohet në Kosovë. Nëse gjendja e kështillë kulturore del si e mirëqenë në ato vite, atëherë për cilën poezi konvencionale është fjala këtu, që poeti paskësh hequr dorë?! Sepse, vetëdijshëm, mund të shtrohet një dilemë interesante: poeti Martin Camaj ka hequr dorë nga krijimtaria e tij e krijuar një zot e di ku, në Shkodër, në shkollën françeskane, apo në Beograd, ku ishte vendosur pas ikjes nga Shqipëria e pas Luftës së Dytë Botërore, por kjo krijimtari është botuar në Prishtinë, në vitet 1953 dhe 1954. Pikërisht këto krijime vetëm, pasi i ka krijuar në Romë të Italisë dhe në Munih të Gjermanisë, autori i konsideron krijime *fillestare dhe konvencionale*?! Poezia e re shqipe në Kosovë fillon të krijohet dhe të botohet pas botimit të këtyre dy vëllimeve të Martin Camajt. Sipas njohurive që dihen, nuk ishte aspak më e mirë gjendja as në Shqipërinë politike, edhe pse ishte shtet që nga viti 1912 e këndej.

Çështje të krijimit dhe çështje të ndikimeve

Disa studiues të poezisë së Martin Camajt kanë thënë se ai sjell në dy vëllimet e tij edhe frymën e Qarkut letrar të Shkodrës, pra thonë ata, hetohet ndikimi i poezisë së Mjedës dhe i poezisë e prozës së Migjenit. Ndonjë tjetër shkon edhe më larg, duke thënë se hetohet ndikimi i poezisë së Lasgush Poradecit. Një dorë studiuesish mendojnë se megjithatë kjo nuk është e pranishme në poezinë e Martin Camajt në vëllimet e botuara në Prishtinë. Dilema e parë që hapet këtu, është fakti se çka do të mund të konsiderohej ndikimi në kohën kur është krijuar poezia e Martin Camajt e këtyre dy vëllimeve, si dhe, çka kuptohet me ndikimet sot, sigurisht nën tryshninë e madhe të literaturës teorike të përkthyer këto njëzet vjetët e fundit në Tiranë e pak më herët e përkthyer keq në Prishtinë.

Poezia e Martin Camajt e përfshirë në vëllimet *Një fyell ndër male* dhe *Kanga e vërrinit*, siç dihet kaheerë kjo punë, është krijuar në fillesën e poezisë së re shqipe që krijohet në Kosovë. Ky fakt jashtëletrar jep

mundësi vetëm për të pasur një qasje objektive për sociologjinë e kësaj poezie, kurrsesi edhe për poetikën e saj, aq më pak edhe për ndikimet në këtë poezi. Siç ka thënë edhe Andre Zhid, që në vitin e largët 1900 në një qerthull letrar në Bruksel, kur e kishin ftuar të fliste për ndikimet. “Kam ardhur këtu të flas në mbrojtje të ndikimeve (...). Ndikimet veprojnë sipas ngjashmërive (...)”. (*Ligjëratë e mbajtur në Libre Esthetique në Bruksel*). Përkimet, ngjashmëritë kaheerë janë të mundshme, sepse, që nga antikiteti kinez nuk ka se çfarë thuhet e re tjetër me gjuhën e poezisë, kurse ndikimet, në vend që të trajtohen si anë negative në krijimtarinë poetike të një krijuesi, kanë vlerë të mirëfilltë vetëm në kuadër të akëcilës krijimtari dhe të akëcilit krijues brenda kohës kur ka krijuar. Prandaj, ngjashëm me ndikimin e strukturës së krijimeve poetike të Qarkut letrar të Shkodrës për të cilën thuhet se ka ndikuar në poezinë e këtyre viteve të Martin Camajt, është thënë, doemos vetëm nga një dorë studiuesish të poezisë së tij, edhe për ndikimin e poezisë së këtyre dy vëllimeve të Martin Camajt në poezinë që është krijuar më vonë nga krijuesit e rinj në Kosovë. Janë përmendur edhe emra të caktuar, si Din Mehmeti, Azem Shkreli e ndonjë tjetër. Janë zënë në gojë edhe rrafshet e ngjashmërive të mundshme. Mirëpo, me sa di unë dhe sa thotë literatura teorike e derisotme, sidomos ajo angleze dhe amerikane, numërimi i disa gjedheve të këtyre ngjashmërive nuk mund të përkufizohet si çështje e ndikimeve.

Martin Camaj dihet se ishte një lexues i pasionuar. Po ashtu, dihet se shkolla françeskane e Shkodrës krijonte studiues të disiplinuar, por edhe krijues me dije të mirëfillta për aktin e krijimit. Një dilemë që nuk është prekur kur është folur rrallë e tek për poezinë e këtyre dy vëllimeve të Martin Camajt, lidhet me faktin nëse ka mësuar poeti ynë nga shkolla poetike që në atë kohë ishte mjaft e zhvilluar në Mal të Zi, pasi dihet se Camaj e njihte gjuhën sllave. Me sa vërej unë, në poezitë e këtyre dy vëllimeve nuk hetohet as stili, as fjalori poetik, as imazhet përshkruese të natyrës, fjala vjen, të përmbledhjes me poezi *Ardhësit: Këngët e Ali Binakut* të Radovan Zogoviqit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për krijuesit e këtij brezi, apo edhe të atyre më të rinj malazezë. Rrafshe përkimesh të poezisë së Martin Camajt në këto dy vëllime me poezinë që krijohet atëherë në Mal të Zi edhe mund të ketë, sidomos në planin e ideve, por në planin e strukturës poetike, diçka e tillë nuk mund të vërtetohet.

Përkundër faktit se autori Martin Camaj ka hequr dorë, sipas një lagjeje studiuesish të poezisë së tij, nga këto dy vëllime si konvencionale, ato edhe si të tilla kanë vlerë historike, kanë vlerë kulturore dhe kanë vlerë letrare, brenda përmasës së kohës kur janë krijuar. Kurse, vlerë të veçantë kanë se janë prijatë të poezisë së re shqipe që krijohet në Kosovë.

Këtu, për hir të temës së këtij shkrimi, nuk e shoh të udhës të shqyrtoj çështjen e ndikimeve të poezive të proveniencave të ndryshme europiane në krijimtarinë e mëvonshme të Martin Camajt, edhe për faktin se janë përsëritur të njëjtat përkufizime që janë thënë edhe për ndikimet e mundshme në poezinë e këtyre dy vëllimeve të fillesës së krijimtarisë së tij poetike.

Këtu më vjen për mbarë ta përmend një mendim të Heminguejt lidhur me aktin krijues dhe me veprën letrare: “Për një shkrimtar të vërtetë, çdo libër i ri duhet të jetë një fillim i ri, një nisje e re drejt diçkaje që s’e arrin dot. Atij i duhet vazhdimisht të përpiqet të bëjë diçka, që s’është bërë ende asnjëherë e që edhe të tjerë janë rrekur ta bëjnë, por më kot. Ndonjëherë, në e ndihet edhe fati, do t’ia dalë mbanë”.

“Më vonë, autori distancohet nga dy vëllimet fillestare dhe konvencionale”, thotë në një vend në studimin e tij, Lanksh. Dilema e parë që i vjen në mendje lexuesit është kjo: atëherë cilat konsiderohen krijime fillestare dhe jokonvencionale të Martin Camajt, si dhe, ana tjetër e dilemës, kur fillon krijimtaria e tij poetike më 1958 në Romë, kur i botohet romani *Djella* me plot poezi brenda, apo më 1953 në Prishtinë?!

Atëherë, çka është me rëndësi se a ka hequr dorë autori nga këto dy vëllime poetike për shkak të vlerës së tyre konvencionale!?

Historia e kulturës së një populli, rrjedhimisht edhe historia e poezisë shqipe, nuk më thotë mendja se e ka për detyrë të merret me vendime të autorëve, cilatdo qofshin ato, lidhur me vepra të caktuara të tyre, të krijuara në akëcilën periudhë kohore.

Poezia e Martin Camajt dhe fillet e poezisë shqipe në Kosovë

Poezia e Martin Camajt e dy vëllimeve të para, *Një fyell ndër male* dhe *Kanga e vërrinit* karakteristikë themelore ka emocionin dhe figurën poetike me taban jetën e vendlindjes së poetit. E këtillë është edhe poezia e poetëve shqiptarë që krijojnë në Kosovë pas këtyre viteve, thuajse deri në vitet ’70, siç janë Din Mehmeti, Azem Shkreli e krijues të tjerë të këtij brezi. Kurse për poezinë e Esad Mekulit, qoftë për çështjen e ndikimeve, qoftë për mundësinë e njohjes së saj nga ana e poetit Martin Camaj të këtyre viteve nuk bëhet fjalë askund. Sa duket, Martin Camaj ka mundur ta njohë poezinë sllave, sidomos atë që është krijuar në Mal të Zi, më herët se poezinë e Esad Mekulit. Fjalori poetik i këtyre dy vëllimeve të Martin Camajt është po ai që e gjejmë edhe te poetët e tjerë shqiptarë që kanë krijuar në Kosovë. Mirëpo, nuk më thotë mendja se këtu mund të bëhet fjalë për punë ndikimi të poezisë së Martin Camajt, fjala vjen në poezinë e Din Mehmetit, apo të Azem Shkrelit, apo të Fahredin Gungës, e të ndonjë

tjetri. Janë disa arsye pse mund të thuhet kështu. Së pari, si edhe Martin Camaj, edhe krijuesit e tjerë të poezisë shqipe në Kosovë ishin shumë të rinj, që të kishin mundësi të njihnin rrjedhën e krijimeve të njëri-tjetrit. Së dyti, ata përfaqësisht kishin përbërës të ngjashëm apo të përafërt të gjeografisë së vendlindjeve. Së treti, lidhur me kohën kur është krijuar poezia e tyre, edhe në Shqipëri realizmi socialist ende nuk kishte lëshuar shtat, nuk ishte bërë normë zyrtare në krijimtari, kurse në Kosovë gjendja ishte edhe më e rëndë, sepse plagët e luftës jo vetëm nuk ishin mbyllur, por ato tashti rridhnin gjak ndryshe në emër të vëllazërim-bashkimit sërish përgjakej populli shqiptar i kësaj pjese të atdheut. (Një shembull shumë interesant: jeta e personazhit Dyl Mehmeti në romanin *Karvani i bardhë* të Azem Shkrelit). Poetët shqiptarë që krijonin, ishte e pamundur të mos e ndienin në kurriz këtë barrë të një robërie ideologjike, siç ishte e pamundur të mos ishin pjesëmarrës në jetën shoqërore që asaj kohe. Pse në poezinë e tyre nuk janë këto plagë, pse jeta shoqërore e shqiptarëve, pra edhe e vendlindjeve të tyre, jepet mes dy periudhash kohore: ajo që kishte qenë para Luftës së dytë Botërore, që ishte sinonim i robërisë dhe i skllavërimit, si dhe ajo që jepej pas ardhjes së ashtuquajturës liri, të cilën e gjejmë edhe në mjaft poezi të krijuesve shqiptarë që krijonin në Kosovë në këtë periudhë kohore. Tashti, del një dilemë tjetër, si është e mundur që poezia e Martin Camajt e dy vëllimeve të tij të para, nga të cilat paska hequr dorë duke i cilësuar si krijime fillestare dhe konvencionale, të ketë ndikuar te poetët e poezisë shqipe që kanë krijuar në Kosovë, e nuk ka ndikuar gjendja e përgjithshme e jetës së shqiptarëve në atë kohë? Marrë në tërësi, edhe poezia e popujve të tjerë të Ballkanit, veçmas e atyre që përbënin ish-Jugosllavinë ishte e tillë, me ata përbërës të poetikës, si dhe me atë fjalor poetik. Prandaj, sërish çështja e ndikimeve të poezisë së këtyre dy vëllimeve të Martin Camajt del e diskutueshme, qoftë edhe vetëm për nivelin e informacionit kulturor që kishin krijuesit e poezisë shqipe që krijonin në Kosovë. Ndoshta këtu mund të kërkohej arsyeja e mungesës së përfshirjes së çështjeve të ndryshme që kanë shtruar një numër studiuesish shqiptarë e të huaj lidhur me krijimtarinë letrare të Martin Camajt, që thuajse tërësisht kanë lënë anash poezinë e këtyre dy vëllimeve.

Niveli i realizimit artistik të poezisë shqipe në përgjithësi në vitet '50-'60 dhe realizimi i poezive në këto dy vëllime të Martin Camajt, në përbërësit kryesorë të tyre u cekën më sipër.

Në kohën e krijimit të poezive të këtyre dy vëllimeve, pa marrë parasysh se paskësh hequr dorë autori nga ato për shkak të nivelit fillestar dhe konvencional të tyre, nuk mund të ishte gjë tjetër, përveç faktit nëse krijimi poetik ende trajtohet edhe si çështje e frymëzimit hyjnor. Sa di unë,

poetët, krijuesit e këtyre viteve në poezinë shqipe, sidomos të poezisë shqipe që krijohej në Kosovë, ende nuk e kishin as përvojën, as informacionin kulturor shqiptar e të huaj, ku do të mësohej ajo përvoja e madhe e përdorimit shtresor të kuptimit të Fjalës. Poetët e poezisë shqipe të kësaj periudhe në Kosovë, andaj edhe Martin Camaj, fjalën poetike kryesisht e kanë përdorur për të dhënë gjendje të situatave, përshkrim ngjarjesh, vendesh, a njerëzish, si dhe shtresime të kujtimeve të fëmijërisë, që bëjnë pjesën më të madhe të krijimeve të tyre poetike, andaj edhe të krijimeve poetike *Një fyell ndër male* dhe *Kanga e vërrinit* të Martin Camajt.

Niveli i poezisë shqipe që krijohej në Kosovë ende nuk e kishte arritur nivelin e zhvillimit, sa të arrinte një efekt poetik pa e përdorur një fjalë, që është shkolla e kursimit të gjuhës së përshkrimit, e cila si nivel i poezisë së një vendi a një gjuhe, është fillimi i zhvillimit të saj. E tillë ishte edhe poezia e këtyre dy vëllimeve të Martin Camajt, siç ishin të këtilla edhe pjesa më e madhe e vëllimeve poetike të poezisë shqipe që krijohej në Kosovë të botuara në vitet '50-'60.

BIBLIOGRAFI

- Martin Camaj, *Një fyell ndër male*, Prishtinë, 1953
Martin Camaj, *Kanga e vërrinit*, Prishtinë, 1954
Koçi Petriti, *Mbi poetikën e Martin Camajt*, Tiranë, 1997
Koçi Petriti, *Ernest Koliqi, 28 vjet pas vdekjes*, Shekulli, Tiranë, janar 2005
Isak Ahmeti, *Kleri katolik shqiptar dhe letërsia*, Bergamo, Itali, 1994
Hans-Joachim Lanksch, *Ditët kur mësoja shqipen me Martin Camajn*, Gazeta shqiptare, Tiranë, 21 korrik 2009
Anton N. Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt* (Botimi i dytë i rishikuar dhe i shtuar), Tiranë, 2000